



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

VENDIM

Nr. 63, dt. 06.04.2016

Në mbështetje të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 06.04.2016, pasi rishqyrtoi projektin e për rikonstruksionin të ndërtesës së MZHU, me subjekt kërkues Ministrinë e Zhvillimit Urban,

VENDOSI:

1. Miratimin e projektit të rikonstruksionit të godinës ekzistuese të Ministrisë së Zhvillimit Urban (MZHU), Tiranë, me vërejtjet e mëposhtme:
 - Të restaurohet volumi i godinës origjinale e viteve '30.
 - Të rikonstruktohet volumi i shtesës ekzistuese në nivelin +3, duke ruajtur konfiguracionin ekzistues të fasadës perëndimore, duke plotësuar volumin e saj sipas vendimit të KKR nr. 119, dt. 03.07.2015 dhe duke harmonizuar rifiniturat e tij me materialet e fasadës së objektit të viteve '30.
2. Miratohet varianti i ngjyrës terrakotë për fasadat e godinës së MZHU.
3. Nuk miratohet asnjë shtesë anësore e volumit të godinës ekzistuese të MZHU.
4. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI

SEKRETAR I KKR

ARTA DOLLANI

